

Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development	KOMUNA E VUSHTRRI - KOMUNA VUSHTRRI
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	KOMUNA E VUSHTRRI - OPŠTINA VUSHTRRI
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development	02 Ne / 2017 - 1002 / 17
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development	No. / Dz. / Date - 03 -
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development	Datum / Date - 04.09.2017
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development	VUSHTRRI - VUČETIN



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva I
Ruralnog Razvoja – Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

NH „IBER-LEPENC“ SH.A.

01-2364 DL 13.09.2017
PRISHTINE - PRIŠTINA



NH „IBER - LEPENC“ SH.A.
HE „IBER - LEPENC“ J.S.C.
VP „IBER - LEPENC“ D.D.



KOMUNA E VUSHTRRI
OPŠTINA VUSHTRRI
MUNICIPALITY OF VUSHTRRI

MEMORANDUM BASHKËPUNUMI PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT TË ZGJERIMIT TË SISTEMIT TË UJITJES

I lidhur ndërmjet:

1. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; (MBPZHR),
2. Komuna e Vushtrrisë, dhe
3. NH „Iber Lepenci“ SH.A. (IL) – Prishtinë

Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me qëllim të kontributit të dhëne në zhvillimin e bujqësisë, do të investojë në zbatimin e Projektit të zgjerimit të sistemit të ujites në fshatin Samadrexhë dhe Panitnë të Komunës së Vushtrrisë.

Palët janë pajtuar si në vijim:

Neni 1
Qëllimi

Ky memorandum i bashkëpunimit ka për qëllim zgjerimin e sistemit të ujites në fshatin Samadrexhë dhe Panitnë - Komuna e Vushtrrisë.

Neni 2
Fushëveprimi

Dispozitat e këtij memorandumi të bashkëpunimit janë të obligueshme për zbatimin e të gjitha aktivitetave të përcaktuara për zgjerimin e sistemit të ujites, në koordinim të përbashkët me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Komunën e Vushtrrisë, dhe NH „Iber Lepenci“ SH.A. (IL) – Prishtinë.

Neni 3
Obligimet e MBPZHR

1. MBPZHR, obligohet që tē ndajë mjetet financiare dhe tē mbuloi koston e tērësishme tē riparimit tē zgjerimit tē sistemit tē ujitjes nē fshatin Samadrexhē – zgjerimin e rrjetit nē Doberllukë, rregullimin e gypave tē metalit nē Pantinë, tek dalja e pompare dhe rregullimi i Pusetës nē Stanoc.
2. Mjetet financiare tē ndara nga paragrafi 1 i këtij nenii ndahen nga investimet kapitale tē Kodit organizativ nr.40100 DPB&T tē MBPZHR-së.
3. Mjetet financiare nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij nenii MBPZHR-ja i barten operatorit Ekonomik tē përgjedhur nga Ministria nē pajtim me kushtet e kontratës, si dhe raportet e menaxherit të kontratës që kryen pagesat nē bazë tē situacioneve.

Neni 4
Obligimet e Komunës

1. Komuna e Vushtrrisë obligohet që tē krijojë kushtet e nevojshme pér zbatimin e projektit nga nenii 1 i këtij memorandumi tē bashkëpunimit.
2. Komuna merr pér obligim evitimin e pengesave eventuale tē natyrës juridiko-pronësore nē tokat që gjenden nē zgjerimin e sistemit tē ujitjes.

Neni 5
Obligimet e NH "Ibër-Lepenci" SH.A. (IL)

1. NH "Ibër Lepenci" SH.A. obligohet që tē krijojë kushtet e nevojshme pér zbatimin e projektit nga nenii 1 i këtij memorandumi tē bashkëpunimit.
2. NH "Ibër Lepenci" SH.A. merr pér obligim evitimin e pengesave eventuale tē sistemit tē ujitjes.
3. NH "Ibër Lepenci" SH.A. mbas pranimit teknik tē projektit merr pér obligim menaxhimin e këtij zgjerimi tē sistemit tē ujitjes.

Neni 6
Komisioni pér mbikëqyrjen (Menaxheri i Projektit)

1. Komisioni, formohet me Vendim tē Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural nē përbërje prej tre 3 anëtarësh nga Ministria, një anëtar nga Komuna dhe një anëtar nga NH "Ibër Lepenci".
2. Komisioni nga paragrafi 1 i këtij memorandumi tē bashkëpunimit bënë mbikëqyrjen e zbatimit dhe pranimit teknik tē projektit tē zgjerimit tē sistemit tē ujitjes, ne bashkëpunim me kompaninë mbikqyrëse.

Neni 7
Ndryshimet dhe plotësimet

1. Me pëlqimin paraprak të palëve nënshkruese, memorandumi mund të ndryshohet dhe plotësohet.
2. Pala e cila dëshiron ndryshimin – plotësimin e këtij memorandumi është e obliguar që në afat prej 30 ditësh, paraprakisht të paraqes kërkesën në formë të shkruar.
3. Në rast se konstatohet se Komuna e Vushtrrisë apo NH "Ibër-Lepenci" SH.A. (IL) nuk i ërm bush obligimet e veta të dala nga ky memorandum, atëherë MBPZHR e mban të drejtën e ndërprerjes së mjeteve financiare të destinuara për zbatimin e këtij projekti.

Neni 8

Në rast të mos marrëveshjeve eventuale lidhur me aplikimin e dispozitave të këtij Memorandumi të Bashkëpunimit, palët do të tentojnë t'i zgjedhin me marrëveshje, nëse kjo nuk mund të arrihet, atëherë secila palë do ta këtë të drejtën e inicimit të procedurës adekuate në Gjykatën kompetente në Prishtinë.

Neni 9

Ky Memorandum i Bashkëpunimit është hartuar në dy (3) kopje identike, nga një për secilën palë kontraktuese.

Neni 10

Ky Memorandum i Bashkëpunimit hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUŠTRRI
02 Nro / No: <u>1020/HZ</u>
Nr. i fpl. / Doc. nr: <u>-02-</u>
Datum / Datum: <u>11.09.2017</u>
VUŠTRRI - VUŠTRRI



REPUBLIKA E KOSOVËS

Data e nënshkrimit të Marrëveshjes me Participim: 11.09.2017

Bр. "Adem Jashari" nr. 1 tel. 088 571 594

KOMUNA E VUSHTRRISË

Duke u bazuar në nenin 17 pika a zhvillimi lokal ekonomik të Ligjit me **Nr.03/L-040**, si dhe Thirrjes për Aplikim të Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural me Nr:09-007-38 të datës: 19.06.2017, lidhë këtë:

MARËVESHJE ME PARTICIPIM (Për projektin "Makina për përgatitje të silazhit të barit")

E përpiluar në mes të:

1. Komunës së Vushtrrisë të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës z.Bajram Mulaku në njëren anë në vështirësinë e subvencionuesit, dhe

2. Grupit të përfituesëve të makinave për përgatitjen e silazhit që kanë participuar për projektin e lartshënuar të cilën e përfaqësojnë me autorizim:

- Rasim Ismaili nga fsh.Banjskë me Nr.personal:1001797456
- Fitim Xhemë nga fsh.Druarë me Nr.personal:1230439962
- Betim Grabanica nga Vushtrria me Nr.personal:1030422615

Neni 1

Qëllimi

Qëllim i lidhjes së kësaj marrëveshje me participim është përkrahja nga Komuna e Vushtrrisë në ngritjen e kapaciteteve dhe shtimit të fondit të bagëtive.

Neni 2

Lënda e kësaj marrëveshje është participimi vullnetar i grupit të përfituesëve të Komunës së Vushtrrisë, lidhur me sigurimin apo grumbullimin e mjeteve financiare të përfituesëve për realizimin e projektit "Makina për përgatitje të silazhit të barit" në bashkëfinancim me Komunën e Vushtrrisë si subvencionuese kryesore i projektit.

Neni 3

Vlera e përgjithshme e mjeteve që duhet grumbulluar nga participimi i përfituesëve për realizimin e projektit nga nen 1 i kësaj marrëveshje me participim është në vlerën e përgjithshme prej 6 396 €.

Neni 4

4.1 Vlera e mjeteve që ka siguruar Komuna si investitor kryesor për realizimin e projektit lëndor është shuma prej **20,000.00 €**, ndërkëq që projekti të realizohet duhet që përfituesit të participojnë vullnetarisht me mjetet në vlerën e cekur në nenin 3 të kësaj marrëveshje.

4.2 Vlera e tërësishme e projektit nga nen 1 i kësaj marrëveshje është **26,396.00€**

Neni 5

Obligimet e Komunës

Komuna merr për obligim që me sigurimin e mjeteve nga përfituesit të bëjë realizimin e projektit nga nen 1 i kësaj marrëveshje.

Neni 6

Në rast të mos grumbullimit të mjeteve Komuna do të bëjë stopimin e realizimit të projektit lëndor.

Neni 7

Obligimet e përfituesit

- 7.1 Secili përfituesi është i obliguar të paguajë shumën prej 492 €, në llogari të caktuar bankare të Komunës së Vushtrrisë.
- 7.2 Përfituesit janë të obliguar që ti përbahen marrëveshjes në përpikëri.
- 7.3 Përfituesit/et nuk i lejohet ta shesë, tjetërsojë ose ta keqpërdorë subvencionin, në të kundërtën do të ndiqet penalisht.

Neni 8

Për ekzekutimin e kësaj marrëveshje kujdeset:Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa, nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Komunës.

Neni 9

Kjo marrëveshje ka tretmanin e kontratës vullnetare në mes të palëve dhe e njëjtë do të realizohet me përbushjen e obligimeve nga ana e të dy palëve.

P A L È T E M A R R È V E S H J E S

Investitori:

Komuna e Vushtrrisë
z.Bajram Mulaku
(Kryetar i Komunës)



Makina për përgatitje të siçazhit të barit:

- 1.Rasim Ismaili
- 2.Fitim Xhemai
- 3.Betim Grabanica

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISE - OPŠTINA VUČITRN
02 Nr. / Br. <u>1039/17</u>
Nr. I Dq. / Ein. st. _____
Date / Datum <u>13.09.2017</u>
VUSHTRRI - VUČITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, "f" dhe "g" të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të propozimit 10nr.672/17, dt.11.09.2017 të komisionit mbikëqyrës për meremetimin e shkollës fillore në fsh. Bequk, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
PËR FORMIM TË KOMISIONIT

1. Formohet komisioni profesional për vlerësim të gjendjes së konstruktivitetit përkatesisht qëndrueshmërisë fizike të objektit të shkollës në fshatin Bequk në këtë përbërje;
 - 1.1 Ramiz Maliqi, - DUMM, kryesues i grupit
 - 1.2 Egzon Haradinaj, - DI, anëtar
 - 1.3 Hashim Hajrizi, - DKA, anëtar
2. Komisioni në fjalë do të vlerësoj nëse objekti i shkollës në këtë fshat ka qëndrueshmëri fizike dhe arsyeshmëri financiare për renovim për punë të mëtejme për zhvillim të procesit mësimor.
3. Për punën e tij komisioni do të paraqes propozim me shkrim për kryetarin e komunës.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi i dërgohet: Anëtarëve të komisionit, Drejtorit për Arsim dhe Arkivit të Sekretarisë,





REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

U R D H È R E S È

1. Urdhëroj Drejtorinë për Shërbime Publike që të ndërmerr veprime të nevojshme përmes KEDS-it për vodosje të nëntokëzimit në njehsorin e rrymës në objektin ku është i vendosur Arkivi i qytetit në Vushtrri (rr. "Skënderbeu") pasi që ka informacione që nuk ka nëntokëzim në atë objekt.
2. Lidhur me masat e ndërmarrura kërkoj që të informohem me shkrim në afatin sa më të shkurtër.
3. Urdhëresa hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
4. Urdhëresa i dërgohet: Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku

Gj. Nr. / Sh. 1059/17

Nr. i Dp. / Bl. nr. -02-

Datum / Datum 19.09.2017

VUSHTRRI - VUŠTRRI



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada – Government



MINISTRIA E BUDGETIT, PITALIMIT DHE ZHVEILLIMIT RURAL
MINISTERSTVO BUDGETA, PYLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva I
Ruralnog Razvoja – Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

3166/2

No. Sh. No. 18-09-2017
Datum/Date: PRISHTINA PRISTINA

„IBËR-LEPENC“ D.D.
01-2365
DL 13.09.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

NH „IBËR - LEPENC“ SH.A.
HE „IBËR - LEPENC“ J.S.C.
VP „IBËR - LEPENC“ D.D.



KOMUNA E VUSHTRRISE
OPŠTINA VUSHTRRI
MUNICIPALITY OF VUSHTRRI

**MEMORANDUM BASHKËPUNUMI
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E MEMORANDUMIT TË
BASHKËPUNIMIT PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT TË REHABILITIMIT DHE
ZGJERIMIT TË SISTEMIT TË UJITJES**

I lidhur ndërmjet:

1. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
2. Komuna e Vushtrrisë, dhe
3. NH „Ibër Lepenci“ SH.A. (IL) – Prishtinë

Neni 1

Ky Memorandum Bashkëpunimi ka për qellim ndryshimin dhe plotësimin e Memorandumit të Bashkëpunimit për Zbatimin e Projektit të Rehabilitimit dhe Zgjerimit të Sistemit të Ujitjes të dt. 05.09.2017.

Neni 2

Neni 5 i memorandumit të bashkëpunimit bazik fshihet dhe riformulohet me tekstin si ne vijim:

Neni 5

Obligimet e NH "Ibër-Lepenci" SH.A. (IL)

1. NH "Ibër-Lepenci" SH.A. (IL) obligohet që të krijojë kushtet e nevojshme për zbatimin e projektit nga neni 1 i memorandumi të bashkëpunimit të dt.05 Shtator 2017, duke ofruar dokumentacionin përkatës, me përshkrim të detallizuar të punëve dhe pjesëve të ndërrimit, me standarde përkatëse – kompatibile me fazonerinë e „IL“, të nevojshme për procedurat

tenderuese, si dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural do ta kryej mbikëqyrjen dhe pranimin e punëve dhe sistemit në tërësi, pas rehabilitimit.

2. NH "Ibër Lepenci" SH.A, (IL) me vendim formon komision të veçantë, nga komisioni i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, mbas pranimit të punëve, do të pranoj sistemin e rehabilituar në menaxhim të mëtutjeshëm.

Neni 3
Zgjidhja e kontesteve

Kontestet eventuale rrëth përbushjes së këtij memorandumi do të zgjedhën me marrëveshjen e palëve kontraktuese e nëse nuk mund të arrihet marrëveshja, kontestin do ta zgjedh Gjykata kompetente në Prishtinë.

Neni 4

Ky Memorandum Bashkëpunimi është hartuar në tri (3) kopje identike, nga një (1) për secilën palë kontraktuese.

Neni 5
Hyrja në fuqi

Ky Memorandum-Bashkëpunimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit _____/_____/2017.





MUN. / Nr.	1060 / 17
No. / Diz. / Diz. nr.	
Date / Datum:	19.09.2017
VUSHTRRI - VUÇITRIN	



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Në mungesë të mjeteve financiare në Drejtorinë për Shërbime Publike, kategoria mallra dhe shërbime, lejohen mjetë financiare në shumë prej 4727.20 € nga Administrata e Arsimit, kod 92120, nënkategori shërbime kontraktuese tjetra, që do të shfrytëzohen për pagesë të tarifës së kyçes së rrjetit elektrik në objektin e ri të komunës.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Drejtoria për Arsim Drejtoria për Shërbime Publike dhe Drejtoria për Buxhet Financa.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
4. Vendimi ju dërgohet: Drejtorisë për shërbime Publike; Drejtorisë për Arsim si dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISE - OPSTINA VUÇITRN
02. Nro. file: <u>1061/17</u>
Nr. i Dp. / Doc. nr:
Dates / Datum: <u>19.09.2017</u>
VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:


V E N D I M

- Lejohet pagesa e faturës nr.3380 të datës 13.09.2017 në shumë prej 913.50€ (nëntëqindetremdhjetë euro e pesëdhjetë centë) për shpenzimet e krijuar në Hotel "Amazona" Muzakaj – Obiliq, Konferencë Nacionale për qëndrim ditor të personave me nevoja të veçanta, pjesëmarrës nga Ministria, Komunat e Kosovës dhe delegacioni nga Komuna Vaxjo – Suedi.
- Pagesa të bëhet në llogarinë bankare të paraqitur në faturë, nga buxheti i Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
- Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
- Pjesë përbërëse e këtij vendimi është fatura e bashkangjitur në shtojcë.
- Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
- Vendimi i dërgohet: Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku



Aneks i

Memorandumit të Mirëkuptimit të datës 31.07.2017

midis

Komunës së Vushtrrisë

dhe

Shoqërisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ)



Neni 1

Tëma:

Pilot projekt: Modellet e kompostimit të decentralizuar për menaxhimin e mbeturinave organike në Kosovë.

Neni 2

Historik

2.1 Qeveria e Kosovës ka për qëllim përmirësimin e procesit të menaxhimit të mbeturinave komunale në mënyrë efektive dhe efikase. Në këtë perpjekje, qeveria kërkon nga komunat që të fillojnë me ndarjen në burim të mbeturinave organike, pasi ato paraqesin një fraksion të madh (~50%). Posshtu një nga objektivat e përcaktuara në Strategjinë e Kosovës për menaxhim e mbeturinave (2013-2022) është që të zvoghet sasia e mbeturinave organike që përfundojnë në deponi për 55%, deri në vitin 2022.

2.2 Në këtë përpjekje, Komuna e Vushtrrisë është mbështetur nga Projekti i GIZ-së për Menaxhimin e Qëndrueshëm të Mbeturinave (Menaxhimin e Mbeturinave) (GIZ SMS). Kjo mbështetje është në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit 04/L-060/2012 për Mbeturinat dhe është përcaktuar në një Memorandum të Mirëkuptimit që është nënshkruar më datën 31.07.2017.

Në këtë kuader, pilot projekt i tanishëm është hartuar në bashkëpunim të ngushtë me Organizatën Jo-Qeventare (OJQ) " Fondacioni Jeshil".

Neni 3

Kohëzgjatja

Tetor 2017 deri në Mars 2019

Neni 4

Qëllimi i projektit

Të dizajnohen dhe implemenohen modele, të ndryshme të kompostimit, të decentralizuar në Kosovë, me qëllim të menaxhimit të mbeturinave organike përmes ndarjes së mbeturinave në burim dhe përdorimit të metodave miqësore ndaj mjedisit.

Neni 5

Objektivat specifike:

5.1 Të promovohen praktikat e mira të menaxhimit të mbeturinave, duke i reduktuar mbingarkesat në deponi;

5.2 Të krijohen kushtet për nxitjen e sektorit të ekonomisë së gjelber në Kosovë, me qëllim të krijimit të vendeve të reja të punës, në veçanti për grupet e marginalizuara;

5.3 Të studiohet mundësia e përsëritjes së veprimitarisë së kompositimit dhe rritjes së shkallës së projektit në përgjithësi;

5.4 Të inkurajohen praktikat e mira të menaxhimit të bonitetit të tokës;

5.5 Të krijohet harta e zinxhirit të vlerave, për prodhimin dhe shfrytëzimin e kompostit;



Neni 6

Qasja

6.1 Modelli i planifikuar pér komunën e Vushtrrisë ka pér qëllim të implementoj kompostimin e decentralizuar në shkallën më të ulët, në amvisëri. Pér këtë model, në bashkëpunim me komunën do të përzgjedhet një vendbanim i cili ka më pak se 200 amvisëri, dhe ka mbulueshmëri të mirë me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave. Të gjitha amvisëritë dhe bizneset në vendbanim do të furnizohen me komposter-shtëpiak, dhe do të informohen se si duhet ndarë mbeturinat organike të shtëpisë. Modelli tenton të hulumtoj, sa do të zgjodhet sasia e mbeturinave që grumbullohen nga kompania Unitetit dhe që sot përfundon në deponi, atëherë kur amvisëritë dhe bizneset do të kenë mundësi që ato t'i shfrytëzojnë pér prodhim të plehat pér nevoja të veta.

6.2 Rezultatet e pritura nga ky model do të janë:

- se cilë amvisen prodhan pleh organik pér nevoja të veta,
- afër 200 ton / vit e mbeturinave organike devijohen nga deponia dhe këshfu evitohen dëmet në ambient,
- afro 1200 € / vit - takse pér deponim, kursehet nga paraja publike,
- ndërtohet një model funksional i ndarjes së mbeturinave organike në burim, i cili tregon nëse përfitimet ekonomike janë evidente, dhe këshfu ofron mundësi të përsëritjes në vendbanimet dhe komunitet tjetra, në vend.

Neni 7

Qasja

Rolet dhe Përgjegjësítë:

Paiet nënshkruese bien dakord pér rolet dhe përgjegjësítë e tyre si më poshtë:

7.1 Komuna e Vushtrrisë është përgjegjëse pér:

- 7.1.1 ofrimin e një zyrtari nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, që duhet të jetë përgjegjës për drejtimin dhe monitorimin e zbatimit të projektit;
- 7.1.2 bashkë-drejtimin e aktiviteteve të projektit;

7.2 Kompania Rajonale-e Pastnimit "Uniteti", është përgjegjëse pér:

- 7.2.1 sigurimin e të dhënave mujore, në lidhje me mbledhjen e mbeturinave në vendbanimin e përzgjedhur, që nga fillimi i projektit dan në fund të periudhës së zbatimit;

7.3 GIZ është përgjegjëse pér:

- 7.3.1 ofrimin dhe bartjen e të gjitha shpenzimeve që kanë të bëjnë me shërbime! këshillimore, ekspertizën teknike pér hartimin dhe implementimin e projektit;
- 7.3.2 pagat e personelit të komunës që ndihmojnë bashkëpunimin janë përgjegjësi e Komunës;
- 7.3.3 bartjen e kostove pér furnizim me komposter-shtëpiak të një vendbanimi me më pak se 200 amvisëri;
- 7.3.4 zhvillimin e aktivitetetve pér ngritjen e kapaciteteve dhe të vëtedijes dhe bartjen e kostotove që lidhen me këto aktivitete;



Instituted by
giz GIZ
Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit



Neni 8.

Hyrja në fuqi

Aneks Memorandumi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga palët.

Neni 9.

Palët nënshkruese

Aneks Memorandumi nënshkruhet në tre ekzemplar në original, nga një për se cilën palë.



Z. Bajram Mulaku
Kryetar i komunës së Vushtrrisë

Z. Kai Hofmann
Menaxher i projektit GIZ SMS

Vendi / Data

21/04/2012

Vendi / Data

 REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO KOMUNA E VUSHTRRISE-OPËTINA VUÇITRN	
<u>03 Nëntor 2017</u> / 1110/17	
<u>Nr. faksimile / Telefoni:</u> _____	
<u>Dati / Datum:</u> 27.09.2017	
VUSHTRRI - VUÇITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Në mungesë të mjeteve financiare në Drejtorinë për Administratë, kategoria mallra dhe shërbime, lejohen mjete financiare nga administrata e arsimit, kodi 92120, nënkategori shërbime kontraktuese tjera, për pagesë të pagave mujore për 9 punëtorë të sigurimit fizik dhe 10 punëtorë për pastrim dhe mirëmbajtje të objekteve të komunës, për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor 2017 si vijon:
 - Pastrimi dhe mirëmbajtja 9,480.00 €
 - Sigurimi fizik 9,829.08 €

Totali 19,309.08 €

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Arsim.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
4. Vendimi ju dërgohet: Drejtorisë për Arsim si dhe Arkivit të Sekretarisë.

Kryetari i Komunës



Bajram Mulaku

 REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOŠOVO KOMUNA E VUSHTRRISE - OPŠTINA VUČITRN
03 Nr. / Br. <u>111 / 17</u> Nr. f. / Br. of <u>27.09.2017</u> Data / Datum VUSHTRRI - VUČITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të propozimit të Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport dt. 04.09.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Nga buxheti i komunës, njësia buxhetore – Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport, kategoria subvencione dhe transfere (subvencione për aktivitete kulturore rimore sportive), lejohen mjete financiare në shumë prej 400,00 €, (katërqind euro) në llogari të z. Armend Thaqi, Drejtor Ekzekutiv i Institutit për Studime Ndërkombëtare – Agora, mbështetje financiare për projektin “Thuaj JO Ekstremizmit” që do të realizohet në Komunën e Vushtrrisë.
2. Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport duhet të lidhë marrëveshje me përfituesin e këtyre mjeteve.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Buxhet e Financa dhe Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport.
4. Vendimi hyn ë fuqi në ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi iu dërgohet: Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport, Drejtorisë për Buxhet e Financa dhe Arkivit të Sekretarisë,



Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISE - OPŠTINA VUČITRN
1116/17
Ne. / Nq. / Brr. m.
28.09.2017
VUSHTRRI - VUČITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

- Lejohet pagesa e faturës nr. 0049780, dt.12.09.2017, në shumë prej 89.50 € (tetëdhjetënëntëeuropesëdhjetë cent) për shpenzimet e krijuara në DPH Restaurant "Qamëria" në Vushtrri, me mysafir zyrtar nga komuna Vaxjo – Suedi (dita e dyte e vizitës së delegacionit) në Komunën e Vushtrrisë.
- Pagesa e faturës të bëhet nga buxheti i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
- Fatura dhe kuponi fiskal në original tështë e bashkëngjitur në shtojcë të këtij vendimi.
- Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
- Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
- Vendimi i dërgohet: Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTORISË - OPŠTINA VUČITREN
03.Nr. / Br. <u>1120/14</u>
Nr. i Rq. / Br. id.
Date / Datum <u>29.09.2017</u>
VUSHTRRI - VUČITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të propozimit të Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport dt. 04.09.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Nga buxheti i komunës, njësia buxhetore – Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport, kategoria subvencione dhe transfere (subvencione për aktivitete kulturore rimore sportive), lejohen mjete financiare në shumë prej 150,00 €, (njëqindpesëdhjet euro) në llogari të z. Agim Zymeri nga Vushtrria, mbështetje financiare për të birin Oreand Zymeri për pjesëmarrje në Festivalin Ndërkombëtar të Kitarës në Tiranë që do të mbahet nga data 4-7 tetor 2017.
2. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Buxhet e Financa dhe Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport.
3. Vendimi hyn ë fuqi në ditën e nënshkrimit.
4. Vendimi iu dërgohet: Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport, Drejtorisë për Buxhet e Financa dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku